



AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Buletini i Posaçëm i Njoftimeve Publike

Nr.18 Datë 11.02.2022

Agjencia e Prokurimit Publik

Blv "Dëshmorët e Kombit"

Tel: + 355 4 2277510

e-mail: info.app@app.gov.al

<https://www.app.gov.al>



KREU I PARË

Buletini

i

Prokurimit Publik

♦Hyrje -----	Fq	4
♦ Operatorët ekonomikë të përjashtuar nga pjesëmarrja në prokurimet publike ----	Fq	5
♦ Njoftime të APP -----	Fq	8
♦ Njoftime kontrate -----	Fq	
♦ Njoftime fituesi -----	Fq	
♦ Njoftime të Kontratës së Lidhur -----	Fq	
♦ Njoftime anulim procedure -----	Fq	
♦ Ndreqje gabimesh -----	Fq	
♦ Buletini i Departamentit të Administratës Publike-----	Fq	
♦ Buletini i Ankandit -----	Fq	
♦ Buletini i Ofertave te Qirave -----	Fq	
♦ Koncesione/Partneritet Publik Privat-----	Fq	
♦ Procedura Konkurruese per Leje Minerare-----	Fq	
♦ Njoftime të Tjera -----	Fq	

HYRJE

Buletini i Prokurimit Publik (Buletini) është publikim i Agjencisë së Prokurimit Publik (APP).

Në Buletin do të publikohen njoftimet që kanë lidhje me prokurimin publik, si dhe i gjithë kuadri ligjor për prokurimin, vendimet e udhëzimet në zbatim të ligjit dhe Dokumentat Standarde të Tenderit, në mënyrë që kushdo, duke seleksionuar të gjithë numrat e njëpasnjëshëm të buletinit, të mund të ketë në dispozicion të gjithë kuadrin ligjor në fuqi.

Në Buletin do të publikohen njoftimet e kontratave në mënyrë të përmbledhur, njoftimet për anulimin e procedurave të prokurimit, njoftimet e fituesve si dhe njoftimet për kontratat e lidhura.

Gjithashtu, në Buletin do të publikohet lista e të gjithë operatorëve ekonomikë, të cilët janë të përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik.

OPERATORËT EKONOMIKË TË PËRJASHTUAR NGA PJESËMARRJA NË PROCEDURAT E PROKURIMIT PUBLIK

Operatori ekonomik i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me emër subjekti Donianna, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me Nipt J62410005G, me seli në Tiranë, përjashtohet – 3 (tre) vjet (duke filluar prej datës 04.11.2019 – 04.11.2022)

Operatori ekonomik i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me emër subjekti Trinity Trade Company, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me Nipt K81630026U, me seli në Tiranë, përjashtohet – 2 (dy) vjet (duke filluar prej datës 05.03.2020 – 05.03.2022)

Operatori ekonomik i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me emër subjekti “Copier Computer Center” shpk, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NIPT L12120015F, me seli në Tiranë, përjashtohet – 2 (dy) vjet (duke filluar prej datës 25.06.2020-25.06.2022)

Operatori ekonomik i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me emër subjekti “Alfa Cleaning” shpk, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NIPTL11704004S, me seli në Tiranë, përjashtohet – 29 (njëzetëntë) muaj (duke filluar nga data 02.10.2020-02.03.2023).

Operatori ekonomik i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me emër subjekti “4S”shpk, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NIPT L64425401K, me seli në Lushnjë, përjashtohet – 17 (shtatëmbëdhjetë) muaj (duke filluar nga data 25.11.2020-25.04.2022).

Operatori ekonomik i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me emër subjekti “TIMAK” shpk, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NIPT L62030020B, me seli në Tiranë, përjashtohet – 18 muaj (tetëmbëdhjetë) muaj (duke filluar nga data 12.01.2021-12.07.2022).

Operatori ekonomik i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me emër subjekti “Arlind Dogjani” shpk, Person Fizik, me NIPT L82112047J, me seli në Tiranë, përjashtohet – 18 muaj (tetëmbëdhjetë) muaj (duke filluar nga data 21.01.2021-21.07.2022).

Operatori ekonomik i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me emër subjekti “Erdis” shpk, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NIPT K71804011J, me seli në Tiranë, përjashtohet – 20 muaj (njëzet) muaj (duke filluar nga data 25.02.2021-25.12.2022).

Operatori ekonomik I regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me emër subjekti “ANRI ASHENSOR” shpk, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NIPT L61830027K, me seli në Tiranë, përjashtohet – 10 (dhjetë) muaj (duke filluar nga data 30.04.2021- 28.02.2022).

Operatori ekonomik I regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me emër subjekti “GEAM” shpk, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NIPT K42905201V, me seli në Tiranë, përjashtohet – 10 muaj (dhjetë) (duke filluar nga data 07.05.2021- 07.03.2022).

Operatori ekonomik I regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me emër “PURA-MEDICAL” shpk, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NIPT L71515507M, me seli në Tiranë, përjashtohet – 10 (dhjete) muaj e 7 ditë (duke filluar nga data 14.07.2021-21.05.2022).

Operatori ekonomik I regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me emër “Albania Distribution Chem” shpk, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NIPT L82203011N, përjashtohet – 18 (tetëmbëdhjete) muaj (duke filluar nga data 15.07.2021-15.01.2023).

Operatorie konomik I regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me emër “Malbertex” shpk, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NIPT K71821009N, përjashtohet – 18 (tetëmbëdhjete) muaj (duke filluar nga data 16.07.2021-16.01.2023).

Operatorie konomik I regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me emër “Pharma Plus” shpk, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NIPT L61424012N, përjashtohet – 10 (dhjete) muaj (duke filluar nga data 01.09.2021-01.07.2022).

Operatorie konomik I regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me emër “Victoria Invest” shpk, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NIPT K32712206U, përjashtohet – 10 (dhjete) muaj (duke filluar nga data 14.09.2021-14.07.2022).

Operatorie konomik I regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me emër “Victoria Invest International” shpk, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NIPT L02712202J, përjashtohet – 10 (dhjete) muaj (duke filluar nga data 14.09.2021-14.07.2022).

Operatorie konomik I regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me emër “Kombi Invest” shpk, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NIPT K43407402P, përjashtohet – 18 (tetëmbëdhjete) muaj (duke filluar nga data 14.09.2021-14.03.2023).

Operatori ekonomik i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me emër “Jupiter Group” shpk, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NIPT K91306035G, përjashtohet – 5 (pesë) muaj (duke filluar nga data 18.10.2021-18.3.2022).

Operatori ekonomik i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me emër “Kadra” shpk, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NIPT K31321008J, përjashtohet – 12 (dymbëdhjetë) muaj (duke filluar nga data 26.10.2021-26.10.2022).

Operatori ekonomik i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me emër “C O L O M B O” shpk, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NIPT J82916489E, përjashtohet – 12 (dymbëdhjetë) muaj (duke filluar nga data 05.11.2021-05.11.2022).

Operatori ekonomik i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me emër “ANTLANTIK 3” shpk, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NIPT K22218003V, përjashtohet – 3 (tre) muaj (duke filluar nga data 10.01.2022-10.04.2022).

Operatori ekonomik i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me emër “ALIAJ-79” shpk, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NIPT L47521901E, përjashtohet – 10 (dhjete) muaj (duke filluar nga data 27.01.2022-27.11.2022).

Operatori ekonomik i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me emër “KORSEL” shpk, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NIPT J64104124G, përjashtohet – 18 (tetëmbëdhjete) muaj (duke filluar nga data 27.01.2022-27.06.2023).

Operatori ekonomik i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me emër “DAS OIL” shpk, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NIPT L52230020G, përjashtohet – 12 (dymbëdhjetë) muaj (duke filluar nga data 31.01.2022-31.01.2023).

Operatori ekonomik i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me emër “EKM Konstruksion & Teknologji” shpk, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NIPT M02403014N , përjashtohet – 3 (tre) muaj (duke filluar nga data 04.02.2022 -04.05.2022).

Operatori ekonomik i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me emër “Harmonia” shpk, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NIPT J62903480D , përjashtohet – 18 (tetëmbëdhjete) muaj (duke filluar nga data 04.02.2022 -04.08.2023).

Operatori ekonomik i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me emër “Paera” shpk, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NIPT L31505034R , përjashtohet – 5 (pese) muaj (duke filluar nga data 08.02.2022-08.07.2022).

Operatori ekonomik i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me emër “Alcani” shpk, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NIPT J91505006Q , përjashtohet – 10 (dhjetë) muaj (duke filluar nga data 09.02.2022-09.12.2022).

NJOFTIM I APP

Në cilësinë e institucionit qendror përgjegjës në vend për mbarëvajtjen e sistemit të prokurimit publik, koncesioneve/partneritetit publik privat dhe ankandit publik, tregojmë vëmendje të veçantë që të mbledhim çdo informacion që mund të konsiderohet i vlefshëm dhe ndihmues në punën e përditshme.

Me qëllim efikasitetin e sistemit të prokurimit publik në nxitjen e transparencës dhe luftës kundër korrupsionit, APP ju inkurajon të denonconi çdo veprim që vjen në kundërshtim me legjislacionin përkatës dhe që cënon zbatimin e drejtë të tij, duke ju garantuar për ndjekjen e të gjitha hapave të parashikuara nga ligji.

Për denocimet për veprime të kundraligjshme në procedurat e prokurimit janë në dispozicionin tuaj adresa e postës elektronike: info.app@app.gov.al; dhe numrat e telefonit: **04 2 277 510; 04 2 277 515**.

Agjencia e Prokurimit Publik shpreh konsideratën dhe bindjen e saj, në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj, për të indentifikuar çdo veprim që kryhet në kundërshtim me ligjin.

NJOFTIM KONTRATE ME PROKURIM **ELEKTRONIK**

PROCEDURATË KUFIZUARA

NJOFTIME FITUESI PËR PROCEDURATË KUFIZUARA

BASHKIA LEZHË

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATOREVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË
MARRËVESHJEN KUADËR

PËR:

BASHKIMIN E OPERATOREVE EKONOMIK “MCE” SH.P.K & “REAN 95” SH.P.K,
PERFAQESUAR NGA OE “MCE” SHPK, ME ADRESE RRUGA "KAVAJËS", QENDRA "SUN
TOWER", KATI 9, AP.38, TIRANE

BASHKIMIN E OPERATOREVE EKONOMIK “PRO GREEN” SHPK & “HE & SK 11” SHPK
& “STUDIO SERVICES K – SA” SH.P.K, PERFAQESUAR NGA OE “PRO GREEN” SHPK,
ME ADRESE RRUGA “KAVAJES”, QENDRA “SUN TOWER”, KATI 8, AP.30, TIRANE

* * *

Procedura e prokurimit: E Kufizuar, Sherbime, (Procedure e Pershpejtuar-Rindertimi)

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-17371-01-18-2022

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Sherbimi i mbikqyrjes se punimeve me objekt: “Rindertimi i
“Ures se Zeze” mbi lumin “Drin” dhe Rehabilitimi i rruges “Inxhinier Gjadri”, Lezhe”.

Kohezgjatja e kontrates: Afati i realizimit te mbikqyrjes se punimeve do te jete i njejte me afatin e realizimit te punimeve nga shoqeria ndertimore e cila do te zbatoje punimet.

Kohezgjatja e Marreveshjes Kuader: 12 Muaj nga data e nenshkrimit te saj.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]
Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: X oferta ekonomikisht më e favorshme ☐ çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë:

- 1- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “AVE CONSULTING” Shpk, me Nuis K81321002M & “TAULANT” Shpk, me Nuis K61617040L,
- 2- Operatori Ekonomik “GJEOKONSULT & CO” Shpk, me Nuis K91810005U,
- 3- Operatori Ekonomik “MAGNA CHARTA” Shpk, me Nuis L92318021H,
- 4- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “MCE” Shpk, me Nuis L72203065K & “REAN 95” Shpk, me Nuis J61827043V,

5- Operatori Ekonomik “NOVATECH STUDIO” Shpk, me Nuis L01717030C,

6- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “PRO GREEN” Shpk, me Nuis M11517040F& “HE & SK 11” Shpk, me Nuis L19008502B& “STUDIO SERVICES K – SA” Shpk, me Nuis L71305518R,

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “AVE CONSULTING” Shpk, me Nuis K81321002M & “TAULANT” Shpk, me Nuis K61617040L,

2- Operatori Ekonomik “GJEOKONSULT & CO” Shpk, me Nuis K91810005U,

3- Operatori Ekonomik “MAGNA CHARTA” Shpk, me Nuis L92318021H,

4- Operatori Ekonomik “NOVATECH STUDIO” Shpk, me Nuis L01717030C,

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

I. Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “AVE CONSULTING” Sh.p.k, me Nuis K81321002M & “TAULANT” Sh.p.k, me Nuis K61617040L,

Nga verifikimi ne SPE rezulton se:

Se pari, nuk ploteson piken 2.3.2 te kushteve te veçanta te kualifikimit, ku parashikohet se: Operatorët ekonomike duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për mbikqyrje te punimeve te zbatimit si dhe për kategorie e nevojshme për zbatimin e kontratës.

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

NP-1 Punime gjurmimi në tokë.

NP-4 Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale.

NP-5 Punime nëntokësore, ura e vepra arti.

NP-7 Ujësjiellës, gazsjellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje.

NP-9 Punime dhe mbrojtje lumore sisteme hidraulike dhe bonifikime.

NP-11 Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.

NP-12 Punime të inxhinierisë mjedisore

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

NS-1 Punime për prishjen e ndërtimeve

NS-6 Sinjalistika rrugore jondriçuese.

NS-7 Barriera dhe mbrojtje rrugore.

NS-8 Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri.

NS-9 Punime strukturore speciale.

NS-18 Punime topogjeodezike.

NS-20 Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë.

Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e liçensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vëndi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të këtë në liçencën e tij ato kategori punimesh të kërkuar në dokumentat e tenderit, pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk korespondon me të njëjtin numer kategorie me kategorinë e punimeve në liçencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vëndi i origjinës. Në rast të shpalljes fitues të një operatori ekonomik të huaj, ky i fundit do të ekuivalente liçencën përpara lidhjes së kontratës dhe fillimit të punimeve sipas legjislacionit përkatës.

KVO thekson se për të përbushur këto kriter OE-te duhet të paraqesin licensë profesionale për mbikqyrje të punimeve të zbatimit që përfshin kategoritë e kërkuara në DST.

Nga verifikimi në SPE rezulton se njëri nga anëtarët e BOE, konkretisht OE “AVE CONSULTING” Sh.p.k, nuk ka paraqitur licensën profesionale për mbikqyrje të punimeve të zbatimit, duke mos përbushur këto kriter

Se dyti, nuk plotëson pikën 2.3.4 të kushteve të veçanta të kualifikimit, ku parashikohet se: Ofertuesi duhet të ketë në stafin e tij, dhe të figurojnë në licensën e shqërisë (Drejtues teknik) personeli si më poshtë:

a. Inxhinier Ndërtimi	1 (nje)
b. Arkitekt	1 (nje)
c. Inxhinier Elektrik	1 (nje)
d. Inxhinier Hidroteknik	1 (nje)
e. Inxhinier Mjedisi	1 (nje)
f. Inxhinier Gjeodet	1 (nje)
g. Inxhinier Gjeolog	1 (nje)
h. Inxhinier Mekanik	1 (nje)

Si dëshmi për stafin e mësipërm të paraqiten dokumentet si Diploma, Licensat profesionale personale të mbikëqyrjes, Kontrata e punës si dhe të figurojnë në Listë pagesat e punonjësve të shoqërisë për periudhën Shtator 2021 – Nëntor 2021. Për këtë si dëshmi duhet të dorëzohen listëpagesat përkatëse.

KVO thekson se për të përbushur këto kriter OE-te duhet të paraqesin dokumentet si Diploma, Licensat profesionale personale të mbikëqyrjes, Kontrata e punës për stafin e mësipërm si dhe të figurojnë në licensën e shqërisë.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se njëri nga anëtarët e BOE, konkretisht OE “AVE CONSULTING” Sh.p.k, nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion në lidhje me stafin teknik të shoqërisë.

Gjendur përpara këtij fakti, KVO verifikoi marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet paleve pjesë të BOE-se në të cilën është përcaktuar se shoqëria “AVE CONSULTING” Sh.p.k do të mbulojë kategoritë e mëposhtme:

NP-1 Punime gërmimi në tokë.

NP-4 Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale.

NP-5 Punime nëntokësore, ura e vepra arti.

NP-7 Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje.

NP-9 Punime dhe mbrojtje lumore sisteme hidraulike dhe bonifikime.

NP-12 Punime të inxhinierisë mjedisore

NS-1 Punime për prishjen e ndërtimeve

NS-6 Sinjalistika rrugore jondriçuese.

NS-7 Barriera dhe mbrojtje rrugore.

NS-8 Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri.

NS-9 Punime strukturore speciale.

Sa me sipër duke qene se njeri nga anetarët e këtij BOE, konkretisht OE “AVE CONSULTING” Sh.p.k, nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion në lidhje me stafin teknik të shoqërisë, ky kriter konsiderohet i papërbushur.

Sa me sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbështetur nën 76, pika 3/a dhe nën 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në bazuar nën 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e Bashkimit të operatorëve ekonomik “AVE CONSULTING” Sh.p.k, & “TAULANT” Sh.p.k, për mos përbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Bashkimit të operatorëve ekonomik “AVE CONSULTING” Sh.p.k, & “TAULANT” Sh.p.k, skualifikohet.

II. Operatori Ekonomik “GJEOKONSULT & CO” Sh.p.k, me Nuis K91810005U,

Nga verifikimi në SPE rezulton se nuk plotëson pikën 2.3.4, të kriterëve të vecanta të kualifikimit ku parashikohet se OE duhet të kenë në stafin e tyre, dhe të figurojnë në licencën e shqërisë (Drejtuës teknik) personeli si më poshtë:

a. Inxhinier Ndërtimi	1 (nje)
b. Arkitekt	1 (nje)
c. Inxhinier Elektrik	1 (nje)
d. Inxhinier Hidroteknik	1 (nje)
e. Inxhinier Mjedisi	1 (nje)
f. Inxhinier Gjeodet	1 (nje)
g. Inxhinier Gjeolog	1 (nje)
h. Inxhinier Mekanik	1 (nje)

Si dëshmi për stafin e mësiperm të paraqiten dokumentet si Diploma, Liçencat profesionale personale të mbikëqyrjes, Kontrata e punës si dhe të figurojnë në Listë pagesat e punonjësve të shoqërisë për periudhën Shtator 2021 – Nentor 2021. Për këtë si dëshmi duhet të dorëzohen listëpagesat perkatese.

KVO thekson se për të permbushur kete kriter OE-te, duhet të paraqesin dokumentet si Diploma, Liçencat profesionale personale të mbikëqyrjes, Kontrata e punës për stafin e mesiperm si dhe të figurojnë në liçencën e shqërisë.

Nga verifikimi në SPE, rezulton se OE nuk plotëson pikën 2.3.4, të kriterëve të vecanta të kualifikimit në lidhje me disponimin e një drejtuesi teknik “Arkitekt”, pasi për të permbushur kete kriter, ka paraqitur dokumentacion për Zj. Leonora Zalosnjë dhe Zj. Elizabeta Kaja, të diplomuar si Arkitekt, por asnjëra nga keto të fundit nuk figuron në Licensën e shoqërisë nr. MK.1735/20 datë 27.01.2021, të paraqitur nga OE në SPE.

Sa me sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbështetur nën 76, pikë 3/a dhe nën 77, pikë 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në bazuar nën 92, pikë 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e Bashkimit të operatorëve ekonomik “GJEOKONSULT & CO” Sh.p.k, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Bashkimit të operatorëve ekonomik “GJEOKONSULT & CO” Sh.p.k, skualifikohet.

III. Operatori Ekonomik “MAGNA CHARTA” Sh.p.k, me Nuis L92318021H,

Nga verifikimi ne SPE rezulton se nuk ploteson piken 2.3.4, te kriterëve te vecanta te kualifikimit ku parashikohet se OE duhet të kenë në stafin e tyre, dhe të figurojnë në liçencën e shqërisë (Drejtues teknik) përsonele si më poshtë:

a. Inxhinier Ndërtimi	1 (nje)
b. Arkitekt	1 (nje)
c. Inxhinier Elektrik	1 (nje)
d. Inxhinier Hidroteknik	1 (nje)
e. Inxhinier Mjedis	1 (nje)
f. Inxhinier Gjeodet	1 (nje)
g. Inxhinier Gjeolog	1 (nje)
h. Inxhinier Mekanik	1 (nje)

Si dëshmi për stafin e mësipërm të paraqiten dokumentet si Diploma, Liçencat profesionale përsonele të mbikëqyrjes, Kontrata e punës si dhe të figurojnë në Listë pagesat e punonjësve të shoqërisë për periudhën Shtator 2021 – Nentor 2021. Për këtë si dëshmi duhet të dorëzohen listëpagesat perkatese.

KVO thekson se për te përmbushur këte kriter OE-te, duhet te paraqesin dokumentet si Diploma, Liçencat profesionale përsonele të mbikëqyrjes, Kontrata e punës, për stafin e mësipërm si dhe te figurojnë në liçencën e shqërisë.

Nga verifikimi ne SPE, rezulton:

Se pari, nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që provon disponimin e një drejtuesi teknik si Inxhinier Gjeolog.

Se dyti, OE për te provuar disponueshmërinë e 1 (nje) Inxhinier Mjedis, ka paraqitur dokumentacion për Z. Zarif Dervishi, ku nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se ky i fundit është i diplomuar në degën “Kimi”, si “Kimist Teknolog”, pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës.

Theksojmë se për te përmbushur piken 2.3.4, OE-te, për drejtuesin teknik inxhinier mjedis te shoqërisë, duhet te paraqesin dokumentacion për një nga drejtuesit teknik i cili duhet te jete i pajisur me diplome për inxhinieri mjedis te lëshuar nga një Fakultet Inxhinierik i cili ka program studimi për Inxhinieri Mjedis.

Rrjedhimisht dokumentacionin i paraqitur nga “OE” (diploma si Kimist-Teknolog) nuk përmbush kërkesat e pikës 2.3.4, të DST-se, pasi OE nuk disponon 1(nje) Inxhinier Mjedis dhe një Inxhinier Gjeolog.

Sa me sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbështetur nën 76, pika 3/a dhe nën 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale,

autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në bazuar në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e Operatorit Ekonomik “MAGNA CHARTA” Sh.p.k, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Operatori Ekonomik “MAGNA CHARTA” Sh.p.k, skualifikohet.

IV. Operatori Ekonomik “NOVATECH STUDIO” Sh.p.k, me Nuis L01717030C,

Nga verifikimi në SPE rezulton se:

Se pari, nuk plotëson kriterin 2.2.2, të kriterëve të vecanta të kualifikimit ku parashikohet se OE-te duhet të paraqesin një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet të maturuara të taksave dhe tarifave vendore të vitit 2021, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument)

Për të përmbushur këtë kriter OE- te duhet të paraqesin një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet të maturuara të taksave dhe tarifave vendore të vitit 2021.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se OE nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion në lidhje me plotësimin e këtij kriteri.

Se dyti, nuk plotëson kriterin 2.3.4, të kriterëve të vecanta të kualifikimit ku parashikohet se OE duhet të kenë në stafin e tyre, dhe të figurojnë në licencën e shqërisë (Drejtues teknik) përsonele si më poshtë:

a. Inxhinier Ndërtimi	1 (nje)
b. Arkitekt	1 (nje)
c. Inxhinier Elektrik	1 (nje)
d. Inxhinier Hidroteknik	1 (nje)
e. Inxhinier Mjedisi	1 (nje)
f. Inxhinier Gjeodet	1 (nje)
g. Inxhinier Gjeolog	1 (nje)
h. Inxhinier Mekanik	1 (nje)

Si dëshmi për stafin e mësipërm të paraqiten dokumentet si Diploma, Liçencat profesionale personale të mbikëqyrjes, Kontrata e punës si dhe të figurojnë në Listë pagesat e punonjësve të shoqërisë për periudhën Shtator 2021 – Nentor 2021. Për këtë si dëshmi duhet të dorëzohen listëpagesat perkatese.

Theksojme se për të përmbushur piken 2.3.4, OE-te, për drejtuesin teknik inxhinier mjedisi të shoqërisë, OE duhet të paraqesin dokumentacion për një nga drejtuesit teknik i cili duhet të jetë i pajisur me diplome për inxhinieri mjedisi të leshuar nga një Fakultet Inxhinierik i cili ka program studimi për Inxhinieri Mjedisi.

Nga verifikimi në SPE, rezulton se OE për të provuar disponueshmërinë e 1(nje) Inxhinier Mjedisi, ka paraqitur dokumentacion për Zj. Silvana Hila (Nenshati), ku nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se kjo e fundit është diplomuar në degen “Kimi Industriale”, si “Kimi Teknolog” pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës.

Rrjedhimisht dokumentacionin i paraqitur nga “OE” (diploma si Kimist-Teknolog) nuk përmbush kërkesat e pikës 2.3.4, të DST-se pasi OE nuk disponon 1(nje) Inxhinier Mjedisi.

Sa me sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbështetur në nenin 76, pikë 3/a dhe në nenin 77, pikë 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në bazuar në nenin 92, pikë 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e Operatorit Ekonomik “NOVATECH STUDIO” Sh.p.k, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Operatori Ekonomik “NOVATECH STUDIO” Sh.p.k, skualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm për lidhjen e marrëveshjes kuadër:

-Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “MCE” Shpk, me Nuis L72203065K & “REAN 95” Shpk, me Nuis J61827043V,

-Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “PRO GREEN” Shpk, me Nuis M11517040F & “HE & SK 11” Shpk, me Nuis L19008502B & STUDIO SERVICES " K - SA" Sh.p.k, me Nuis L71305518R.

Shënim: Referuar VKM nr.225, datë 12.04.2021 “Për miratimin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit, të kriterëve të vlerësimit të ofertës fituese kushteve të marrëveshjes kuadër dhe të kontratës për procesin e rindërtimit”, kualifikimi i ofertuesëve në fazën e parë, nuk është me pikë.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë Bashkise Lezhe se bashku me dokumentacionin e noterizuar te ofertes tuaj, brenda 3 (tre) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 02/02/2022

Ankesa: Nuk Ka

KONTRATA TË NËNSHKRUARA PËR PROCEDURATË KUFIZUARA

BASHKIA KURBIN

FORMULARI I NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË NËNSHKRUAR

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri	Bashkia Kurbin
Adresa	Lagjia Nr.3, Laç
Tel/Fax	++ 355532 22 270 / 0682205942
E-mail	bashkiakurbin@gmail.com
Faqja në Internet	_____

2. Lloji i procedurës: “Procedurë e Kufizuar, Marrëveshje Kuadër” Shërbime (Prokurim me mjete elektronike), në kuadër të procesit të rindërtimit.

3. Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-12505-11-23-2021

4. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: “Mbikqyrje punimesh për objektin: Rindërtimi i 225 banesave individuale në Bashkinë Kurbin, në kuadër të procesit të rindërtimit”.

5. Fondi limit: 5,184,914 (pesë milion e njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e katërmbëdhjetë) lekë.

6. Vlera totale përfundimtare e kontratës:

Vlera: 5,000,000 (lekë pa TVSH)

Monedha Lekë

7. Data e lidhjes së kontratës 07.02.2022.

8. Emri dhe adresa e kontraktorit /nenkontraktorit

Bashkimi i Operatoreve Ekonomikë “NATASHA MYRTAJ” Person Fizik, me numër NIPTI K37509823M, me adresë: Fier Qender - MALLAKASTER DUKAS Lagjia Dukas, rruga nacionale "Fier Ballsh", zona kadastrale 1566, numer pasurie 93/14, banesa private nr-2 & “INSTITUTI DEKLIADA - ALB” SHPK me numër NIPTI K71606006A, me përfaqësues ligjor Z. Devis Hasalami, me adresë: Tiranë, Rruga Donika Kastrioti, pallati Teknoprojekt, apartamenti 9/1, 1001.

